



## Rregullore mbi mungesat në shkollë

për shkollën primare dhe sekondare të Shkollës së Qytetit Chur (rregullore mungesash)

Vendosur nga drejtoria e shkollës së Shkollës së Qytetit Chur, më 13 prill 2018.

Bazat ligjore:

- Ligji për shkollat popullore të Kantonit Graubünden përfshirë udhëzimin e 21 marsit 2012 (BR 421.000, BR 421.010)
- Ligji për shkollën e Shkollës së Qytetit Chur, 14 nëntor 2013 (RB 711)

Shënim: Në rast dyshimi, vlen versioni gjerman.

### Neni 1 Parimi

<sup>1</sup> Personat me të drejtën e edukimit janë të detyruar, t'i çojnë fëmijët rregullisht dhe përpikërisht në shkollë. Mësimi i shkollës nuk lejohet të humbet pa arsye thelbësore

<sup>2</sup> Nëse vizita e shkollës është e pamundur, duhet të lajmërohet personi mësimdhënës përkatës para fillimit të mëimit.

### Neni 2 Mungesa për shkak sëmundjeje dhe aksidenti

<sup>1</sup> Në veçanti sëmundje, aksident dhe terminë mjeku që nuk mund të shtyhen vlejné si mungesa të justifikuara.

<sup>2</sup> Në rast mungesash për shkak sëmundjesh ose aksidenti të nxënësit mësuesi kujdestar i klasës mund të kërkojë nga personat me të drejtën e edukimit një dëshmi mjekësore.

### Neni 3 Ditë xhoker

<sup>1</sup> Personat me të drejtën e edukimit mund ta heqin fëmijën e tyre maksimumi 4 gjysmë dite për [çdo] vit shkollor nga mësimi. E përjashtuar është heqja menjëherë para dhe pas pushimeve të verës.

<sup>2</sup> Mësuesi kujdestar i klasës duhet të lajmërohet si rregull me shkrim nga personat me të drejtën e edukimit më së voni 1 javë më parë mbi tërheqjen e ditëve xhoker.

### Neni 4 Miratimi i pushimit, përgjegjësitë, afatet e dorëzimit, kushtet

<sup>1</sup> Pushim i arsyetuar në kuptim të lirim të nxënësve dhe nxënësve nga mësimi mund të miratohet në tërësi deri në 15 ditë shkollor në vit (30 gjysmë ditë). Ditët xhoker vendosen për dy ditët e para të pushimit dhe formojnë një pjesë të 15 ditëve të shkollës.

<sup>2</sup> Mungesa të arsyetuara mund të jepen në veçanti për mungesat e mëposhtme në shkollë: Rast vdekjeje brenda familjes; aktivitete fetare me rëndësi; pjesëmarrje aktive e nxënësve dhe nxënësve në gara sportive, konkurse artistike ose shkencore; shërbim në rast të një veprimtarie vullnetare; shkëmbime nxënësish; vizita të vendeve të këshillimit ose të autoriteteve.

<sup>3</sup> Mungesa të motivuara personalisht si p.sh. aktivitete të kohës së lirë, ekskursione ose udhëtime pushimesh nuk vlejné si mungesa të arsyetuara qëndrueshëm në kuptim të pushimit. Nga këto përjashtohen ditët xhoker.

<sup>4</sup> Përgjegjësia për miratimin e ditëve të pushimit delegohet prej drejtorisë shkollore si vijon:

Pushim	Miratimi nëpërmjet:	Afati i dorëzimit në rast të instancës së miratimit:
4 gjysmë ditët e para (ditët xhoker)	Mësuesi kujdestar i klasës	1 javë (informacion)

<sup>5</sup> Si rregull duhet të zbatohen afatet për dorëzimin e kërkesës për pushim.

<sup>6</sup> Miratimi i pushimit mund të jetë i lidhur me kushte. Në rast të mospërbushjes së një kushti, miratimi i pushimit mund të prapësohet.

#### **Neni 5 Pushime më të gjata**

Për dhënien e miratimit për pushime prej më tepër se 30 gjysmë dite (15 ditë shkollore) në vit shkollor është përgjegjës inspektorati kantonial i shkollës. Kërkesat duhet të dorëzohen me argumentimin me shkrim nga personat me të drejtën e edukimit të paktën 20 ditë më parë tek inspektorati i shkollës.

#### **Neni 6 Lajmërimi dhe kontrolli**

<sup>1</sup> Mësuesit kujdestarë të klasës duhet të lajmërohen mundësisht herët dhe me shkrim mbi mungesat në shkollë.

<sup>2</sup> Mësuesit kujdestarë të klasës kryejnë kontrollin mbi mungesat.

<sup>3</sup> Menjëherë pas një mungese nxënësja respektivisht nxënësi duhet t'i paraqitë mësuesit kujdestar të klasës një shënim në librezën e mungesave të nënshkruar nga personat me të drejtën e edukimit.

#### **Neni 7 Mësime nuhatëse profesioni**

Pushime për "mësime nuhatëse profesioni" nuk bien nën kushtet e kësaj rregulloreje. Ato jepen në kuadrin e direktivave kantonale nga udhëheqja e shkollës.

#### **Neni 8 Lirimi i përkohshëm nga lëndë të veçanta mësimore**

Nëse për arsye shëndetësore (e nevojshme dëshmi nga mjeku) nuk është e mundur përkohësisht vizita e një lënde mësimore, mësuesi kujdestar i klasës mund ta lirojë nxënësen ose nxënësin nga mësimi. Në marrëveshje me personat me të drejtën e edukimit do të sigurohet përkujdesja gjatë kohës së zakonshme të mësimi.

#### **Neni 9 Përpunimi i lëndës së humbur të mësimi**

Për përpunimin e lëndës së humbur të mësimi mbajnë përgjegjësi nxënëset dhe nxënësit respektivisht personat me të drejtën e edukimit.

#### **Neni 10 Përcaktime dënimesh**

Prindërit, të cilët nuk e çojnë rregullisht në shkollë fëmijën e tyre pa shkak të justifikuar ose e heqin nga shkolla pa miratim pushimesh, mund të dënohen me një gjobë deri në 5 000 Fr[anga]. Personat mësimdhënës janë të detyruar t'i njoftojnë udhëheqjes së shkollës mungesat.

#### **Neni 11 Hyrje në fuqi**

Kjo rregullore zëvendëson versionin e datës 3 qershor 2016. Hyn në fuqi më dt. 1 gusht 2013.